

MINISTRIA E KULTURËS

RAPORTET E MONITORIMIT

9 - MUJORI - VITI 2014

Programet Buxhetore:

- 1. Planifikim Administrim, Menaxhim**
- 2. Trashëgimia Kulturore**
- 3. Arti dhe Kultura**

RELACIONMBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË VITIT 2014

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, kreu VIII, neni 65 “Monitorimi”, të ligjit nr. 185/2013, “Për Buxhetin e vitit 2014”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” paragrafi VI “Raportet e Monitorimit” dhe Udhëzimit nr. 1/1, datë 19.02.2013 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2013”, shtojcat nr. 7-11, Ministria e Kulturës, për 9 - mujorin e vitit 2014, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore. Me anë të këtij relacioni prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për 9 - **mujorin e vitit 2014**, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 9- mujori 2014		Realizimi 9- mujori 2014		
		Në (000) leke	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	129,619	11.84%	124,490	13.43%	96.04%
2.	Trashëgimia Kulturore	348,986	31.88%	275,052	29.68%	78.81%
3.	Arti dhe Kultura	615,987	56.28%	527,230	56.89%	85.59%
	Totali	1,094,591	100.0%	926,773	100.0%	84.67%
	Financimi i huaj per investime	0	0	0	0	0
	Totali me Financimet e huaja	0	0	0	0	0

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se, buxheti është realizuar në masën 85 %, ku rreth 56 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 86 %, ndjekur nga programi ”Trashëgimia Kulturore shpenzimet e të cilit zënë rreth 32 % të totali dhe janë realizuar në masën 79 %, programi ”Planifikim Menaxhimi” shpenzimet e të cilit zënë rreth 12 % dhe janë realizuar në masën 96 % .

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomikë

G r	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 9- mujori 2014		Realizimi 9- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	622,562	56.9%	594,203	64.1%	95.4%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	269,994	24.7%	240,584	26%	89.1%
12	01110	231	Kapitale	202,035	18.5%	91,986	9.9	45.5%
			TOTALI	1,094,591	100	926,773	100	84.7%
12	01110	231	Jashtë buxhetore					
			TOTALI	1,094,591	100	926,773	100	84.7%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se shpenzimet për 9-mujorin e vitit 2014 për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 95%, shpenzimet korentë 89 %, dhe shpenzimet kapitale, janë realizuar në masën 46 %.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore në masën 15.3% ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i fondeve për investime.

Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1. Programi: "PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM"

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe shpenzimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 9- mujori 2014		Realizimi 9- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	54,774	42.3%	52,766	42.4%	96.3%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	72,844	56.2%	71,352	57.3%	98%
12	01110	231	Kapitale	2,000	1.5%	372	0.3%	18.6%
			TOTALI	129,619	100	124,490	100	96%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 96%, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 42 % të totalit dhe janë realizuar në masën 96%. Shpenzimet korentë zënë rreth 56% të totalit dhe janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 1.5% të totalit dhe janë realizuar në masën 19%.

Mosrealizimi i fondeve në masën 4% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në shtatë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme. Sikurse vihet re nga të dhënat, konstatohet realizimi i produkteve.

në (000) lekë

Programi	Planifikim, Menaxhim, Administrim				01110
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit				
	Emri Produktit	PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 9-mujori 2014	Buxhet/Fakt 9-mujori 2014
A-02113	Paisje elektronike dhe elektrike		23,500	20,250	0
B-01415	Pajisje zyrash		25,500	0	0
C-02459	Akte ligjore e nenligjore		16,000	11,520	29,500
D-02461	Ristrukturim I strukturave aktuale		15,000	15,000	15,000
E-04177	Pagesa vendimesh gjyqesore		16,000	42,174	41,277
F-04248	Auditime		20,000	19,500	18,250
G-02496	Aktmarreshje		22,900	21,175	20,713
Totali			138,900	129,619	124,490

Nga sa mësipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar pjesërisht. Në lidhje me realizimin e produkteve informojmë se procesi i ristrukturimit është kryer brenda numrit të përgjithshëm të MK-së në zbatim të Ligjislacionit në fuqi.

Për sa i përket produktit “Paisje elektronike dhe elektrike” për këtë 9 muor ka patur planifikim por jo realizim pasi vazhdojnë procedurat e tenderimit në Ministrinë e Brëndshmë.

Gjatë 9 muorit të vitit 2014 realizimi i produkti “Akte ligjore dhe nenligjore” realisht është planifikuar vetëm një akt ligjor, ai i ndryshimit të ligjit për kinematografinë, dhe janë realizuar me tepër se çjanë planifikuar, dhe kjo vjen si rezultat i ardhjes së Papa Françeskut në Shqipëri. Përmëdim këtu: VKM e Shpronësimit, Projekt Vendimi për kalimin me përgjegjësi administrative MK disa objekte. Gjithashtu janë ralizuar dhe 4 ose 5 projekt vendime për shtesa fondi në MK në kuadër të ardhjes së Papa Françeskut në Shqipëri.

Në realizimin e Produktit “Nënshkrim Marrëveshjesh” gjatë këtij 9 muori është nënshkruar vetëm një marrëveshje përmëdim [Creative Europe](#), e cila eshte nenshkruar ne qershor dhe hyre ne fuqi ne daten 31 korrik 2014.

Në realizimin e Produktit “Auditime” gjatë këtij 9 muori janë kryer auditime në këto institucione: DRKK Durrës, Muzeu G.J.K Skënderbeu etj.

Gjatë 9 muorit të këtij viti, janë kryer pagesa vendimesh gjyqësore më tepër se çjanë planifikuar pasi ka pasur shtesa gjatë vitit.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 9- mujori 2014		Realizimi 9- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	193,217	55.4%	176,333	64.1%	91.3%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	72,940	20.09%	63,692	23.2%	87.3%
12	01110	231	Kapitale	82,829	23.7%	35,028	12.7%	42.3%
			TOTALI	348,986	100%	275,052	100%	78.8%
12	01110	231	Jashtë buxhetore	0	0	0	0	0
			TOTALI	348,986	100%	275,052	100%	78.8%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 79%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 55 % të totalit dhe janë realizuar në masën 91%, shpenzimet korrente zënë rreth 20% të totalit dhe janë realizuar në masën 87% dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 24% dhe janë realizuar në masën 42%.

Mosrealizimi në masën 21.2 % e totalit konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

Programi	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë				08220
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit			
		PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 9-mujori 2014	Buxhet/Fakt 9-mujori 2014
A-00324	Muze Kombetare me standarte dhe sherbime te permirsuara		100,552	95,854	64,407
B-00324	Infrastruktura arkeologjike, monumentale, peizashistike ne Parqet Arkeologjike		43,462	32,597	25,353
C-00324	Objekte “monument kulture” te konservuara dhe restauruara		237,179	170,769	147,051
D-00324	Aktivitete te trashegimise jomateriale dhe diversitetit kulturor te realizuara		54,441	43,553	32,665
E-00324	Katalogimi i vlerave te trashegimise kulturore		7,966	6,213	5,576

MINISTRIA E KULTURËS

	materiale dhe jomateriale				
	Totali		443,600	348,986	275,052

Produktet e planifikuara në këtë program në përgjithësi janë realizuar.

➤ **“Objekte "monument kulture" te konservuara dhe restauruara**

Ky produkt konsiston në monitorimin, mirmbajtjen, restaurimin, konsolidimin, mbrojtjen e objekteve Monumente Kulture.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare si dhe Parqet Arkeologjike kryejnë në mënyrë të vazhueshme monitorimin, mirmbajtjen restaurimin, konsolidimin e objekteve Monument Kulture, kështu:

DRKK Berat ka kryer Punime mirembajtje në objekte monumente kulture, si Restaurim i fasadës së banesës së z.Irakli Xhimitikut, banesën e Vallëzërisë Mile, në banesën Ilia Budës, banesës së Vasil Shytit, së Hermenak Badajani, së banesës së Lili Nashos, së banesës së Myfit Mehmetit, Naun Dyshnikut, Lili Simsisë, Sotiraq Mbricës, Lefteri Heqimit, Restaurimi i kalldremit te kisha e Shën Mëhillit, Ndërtimi i murit te gurit midis kullave 1&2, Restaurimi i fasadës anësore (veriore) i zyrove të DRKK Berat (Konakët e teqesë), Restaurimi i murit te gurit te Qendra Mesjetare, mirmbajtje e zyrove të DRKK Berat (Konakët e teqesë), Restaurimi i murit të gurit te ish banesa e Vrionasave, Pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët në tre lagjen e qendrës historike si dhe po vazhdon restaurimi I banesës “Haxhistasa.

Është në fazën përfundimtare përgatitja e pasaportave të Monumenteve të Kulturës Kategoria e Parë dhe e dytë, nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare dhe Parqet Arkeologjike një nga prioritetet e Ministrisë së Kulturës për: përditësimin e rregullt dhe rigoroz të listës si dhe verifikimin e statusit të monumenteve të shpallura dhe atyre të propozuar për heqje nga lista si dhe përpilimin e një harte risku për të gjitha monumentet e veçanta por edhe për qendrat historike dhe parqet arkeologjike.

DRKK Durrës Janë kryer punime mirmbajtje e konsolidimi në muret e kalasë së Durrësit, Krujës, Elbasanit, etj. pastrimi nga vegjetacioni Amfiteatrin Romak, ne Forumin Bizantin (Rotonda). Murin e Kalase te qytetit te Durrësit, i Termave Antike, i Bazilikes Paleokristiane ne Arapaj, Durrës, I Murit të Kalasë në Porto Romano, në Banesën Aleksandër Moisiu Durrës, në Kalanë e Tiranës, në Kullen e Sahatit në Kavajë, i murit te kalasë së Elbasanit, i Bazilikes Paleokristiane Elbasan, Kalanë e Zgerdheshit, etj.

U realizua restaurimi i Kishës së Valëshit në Elbasan, si dhe paisja me sinjalistikë dhe tabela shpjeguese të monumenteve si dhe ndriçimi i mureve të kalasë së Durrësit në bashkëpunim me bashkinë Durrës dhe projektin IPA –Adriatic, Tur Grate 2.

U krye restaurimi i sheshit Nënë Tereza si dhe i fasadave te godinave përreth.

DRKK Durrës pas hartimit te projekteve të restaurimit mirmbajtjes e konsolidimit vazhdon procedurat e tenderimit per porten hyrese tek Kalaja e Tiranës, punime mirmbajtje në Amfiteatri Romak si dhe vazhdon puna në Muzeun Etnografik, Kavajë,

DRKK - Gjirokastrë, ka kryer punime mirëmbajtjeje restauruese e konservuese në Kalanë e Gjirokastrës, të Sahatit në kala, kishën e Shen Merise se Laboves etj. DRKK në bashkëpunim

me qytetarët ka kryer punime restauruese e konservuese në disa banesa dhe dyqane monumente kulture, gjithashtu vazhdojnë bashkëpunimet për restaurime me CHëB.

DRKK Vlorë, ka kryermirëmbajtje dhe pastrim nga vegjetacioni i monumenteve Kisha e Marmiroit, Kalaja e Kaninës, Kalaja e Porto Palermos, Kalaja e Mavrovës etj.

Vazhdon puna për “Rikonstruksionin e Kishës së Shën Spiridhonit” si dhe po kryhen ndërhyrje mirmbajtje për nevoja emergjente në disa objekte.

DRKK Vlorë administron dhe mirëmban **Parkun Orikum, Parkun Finiqit, Parkun e Amanties**, në të cilat janë kryer punime mirëmbajtje dhe pastrim i vegjetacionit. Është vendosur sinjalistika dhe tabelat shqip e anglisht dhe janë përgatitur fletëpalosje dhe postera. Në parqet arkeologjike dhe objektet Monument culture Kalja e Porto Palermos, Manastiri i Mesoptamit, Kalaja e Kanines, Bazilika Sarandes, Manastiri i 40 Shenjtoreve kanë patur numër të konsiderueshëm vizitorësh.

DRKK Korçë, Janë kryer punime mirmbajtje dhe restaurimi në rreth 16 objekte Monument Kulture, në Muzeu Kombetar i Arsimit, Kisha e Shën Dhimitrit, Boboshticë, kishen e Shën Mehilit Vithkuq, Shën Merise Vithkuq, Shën Pjetrit Vithkuq, Shën Mërisë Voskopojë, Shën Kolli Voskopojë, Shën Thanasit Voskopojë, kishën e Shën Mihailit dhe Gabrielit Voskopojë, Shen Ilias Voskopojë, ne kishen e Tudasit, kishen e Shen Triadhes Lavdar, në banesen e Pajtim Halimit Korce, ne Muzeun Arkeologjik, në Urën e Golikut Pogradec. Janë hartuar projektet për restaurimin e objekteve në Pazarin e Korçës. Si dhe vazhdon puna në disa objekte në qytetin e Korçës.

DRkk Shkodër ka realizuar një sërë aktivitete dhe janë mirëmbajtur disa objekte monument kulture si: Mirëmbajtje dhe pastrim bimësie në: Kalajnë Rozafa Shkoder, Kalaja Lezhe, Kalaja Drisht, Grazhdanit Diber, Shurdhah, mirmbajtej në banesa e Oso Kukes, banesa e Filip Cekes, banesa e Xhevat Rrepishtit, etj. Gjithashtu janë bere dhe një sere aktivitete kulture dhe mirembajte monumentesh ne bashkepunim me komunitetin. Pastrim i urave monument në Lezhë, pastrim dhe mirmbajtje e urës së Mesit, si dhe punime mirmbajtje të objekteve monument kulture në zonën historike Shkodër.

Nga kjo DRKK është në përfundim rievimi dhe kontrolli i zonave Bulqizë, Mat, Mirditë, Tropojë të fortifikimeve Vig, Marshej dhe Gajtan, Rievim të kishave në sektorin Diber, Rievim i zonës A dhe B dhe kontroll i përgjithshëm në Lezhë.

• “Muze të Rikonstruktuar dhe përmirësuar në infrastrukturë”

Përmirësimet dhe ndryshimet që po ndodhin në infrastrukturen muzeore janë në një proces zhvillimi dhe ngritje në nivele dhe standarte të larta muzeore kështu:

Muzeu Arkeologjik Durrës është në fazën e muzealizimit të tij dhe të vendosjes së guidave shpjeguese nga grupi i punës. Ky proces përfundon në fund të nëntorit 2014 periudhë e cila do të shënojë dhe inagurimin e katit të parë.

Pavioni etnografik në MHK është në fazën e mbylljes së punimeve teknike dhe deri në fund të nëntorit do të përfundojë muzealizimi i tij.

Muzeu i ri i fotografisë Marubi është në proces të miratimit të projektit të zbatimit dhe në fund të nëntorit fillon zbatimi i tij.

Ngritja e Godines se re ku do te zhvendoset i gjithë fondi muzeor i **Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë**. Ministria e Kulturës përmes fondit të zhvillimit të rajoneve mbështet ndërtimin e këtij muzeu në bashkëpunim me Bashkinë Korçë.

Përmirësimi në infrastrukturën e Muzeut Historik Kombëtar në kuadër të vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri. Ky përmirësim konsistonte si në fasadën e jashtme duke përfshirë dhe tarracen edhe në infrastrukturën e brendshme.

Ngritja e muzeut të ri të përgjimeve “shtëpia me gjethe” shton përmirësimin e infrastrukturës muzeore në nivel kombëtar. Ky muze është në fazën e kalimit të objektit nga SHISH tek Ministria e Kulturës si dhe po hartohet projekt ide për muzealizimin si dhe projekti i restaurimit të plotë të godinës. Muzealizimi (project ide) dhe projekti i restaurimit do të prezantohen për publikun në muajin nëntor.

Ngritja e muzeut të Bashkëjetesës është një tjetër strukturë e re muzeore pjesë e përmirësimit të infrastrukturës në nivel kombëtar, ky muze është në fazën e hartimit të projekteve.

• “Infrastrukturë e përmirësuar në Parqet Arkeologjike”

Parqet arkeologjike kryejnë në vazhdimësi mirmbajtjen e territorit si pastrim nga vegetacioni i lartë dhe i ulët, konsolidim të mureve, paisjen e ambjenteve me tabela informuese etj.

Në **Parkun e i Apollonisë** është kryer pastrim dhe mirëmbajtje e kullës së rrumbullaket ne hyrje te parkut, i sektorit Muri i Amforave, te Nimfeut, Agonotetet Odeoni, banesa me impluvium dhe shtëpise me mozaik ,i gjimnazit dhe murit te Temenosit, etj.

Projekti me financim të huaj në sitin arkeologjik të Apolonise “ Restaurimi i Manastirit të Shën Marisë dhe hartimi i Master Planit” do të realizohet në dy vite 2014- 2015.

Parku Bylis punon në vazhdimësi në konsolidimin e mureve, rrugicave, mozaikëve, etj.

Në këto parqe zhvillohen dhe shumë aktivitete të trashëgimisë jomateriale dhe diversitetit kulturor.

Katalogimi i vlerave te trashëgimise kulturore material e jomateriale: “Plotësim i kartelave të Trashëgimisë Kulturore të Paluajtshmë”, janë në vëmendjen e tyre.

Gjatë kësaj periudhe **ZAK Butrint** është përfshirë në disa programe që kanë synuar mirëmbajtjen e monumenteve, kontrollin e vegetacionit, rritjen e shërbimeve turistike, sigurinë për turistët në vizitën brenda parkut por edhe më gjerë në rrethinat.

“Aktvitete te trashëgimise jomateriale dhe diversitetit kulturor te realizuara”

Gjatë 9 muorit të vitit 2014 janë realizuar një sërë aktiviteteve të planifikuara si dhe disa aktivitete në kuadër të vizitës në muajin shtator të Papa Françeskut në Tiranë.

Vazhdon mbështetja e aktiviteteve të realizuara nga shoqata e individë që kanë aplikuar dhe përfituar fondin përkatës të akorduar nga Ministria e Kulturës, në një proces përzgjedhjeje transparent dhe mbi bazë vlerash. Ndër to janë: Festivali i peste i riteve pagane Antigone, Tezgjahistet e reja te Zadrimes, Inventarizimi Digital i Fondit Etnografik Zona para Alpe, Rritja

e ndergjegjesimit dhe kultures muzeale ne Berat, Traditat e Vendit tim, E djeshmja në shërbim të së tashmes, Urat e Beratit flasin, Mbrojtja e dialekteve të gjuhës shqipe, Festivali i 11 instrumentistëve të vegjël Fushe Arrez, Trashëgimia kulturore, pasqyre e vlerave Korce, Oda

Dibrane , Javet e arkitektures ne Tirane, "E ka kush e ka", "Rrenjet e kackavallit", Permeti multikulturor CIOFF, java e serenatës korçare, Rikthimi i grupit të Pilurit, Festivali i 6 ndërkombëtar Bylis polifonia, Trashëgimia e usta Laver Bariut, Ripërtëritja e traditës –panair artizanati, 21 maji –Dita Ndërkombëtare e Diversitetit Kulturor, 8 Prilli Mbasdite Kulturore me fëmijë romë, Miqtë e Monumenteve, 18 Maji, Dita Ndërkombëtare e Muzeve. U realizua për herë të parë linku online lidhur me netëorkun e muzeve kombëtarë sipas shpërndarje gjeografike në vend etj.

Në kuadër të 29 shtatorit Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore u zhvilluan një sërë aktivitete në Tiranë dhe rrethe. U zhvillua tryeza e rrumbullakët për "Restaurimin dhe Arkeometrinë", për herë të parë u zhvillua parada dhe festival vallesh popullore, u hap dhe u ndoq me shumë interes ekspozita e veglave popullore tradicionale në MHK, si dhe në kuadër të ardhjes së Papa Françeskut në Shqipëri në 21 Shtator 2014 një ndër aktivitetet e rëndësishme ishte dhe realizimi i ekspozitës "Besim" në Muzeun Historik Kombëtar .

Në bashkëpunim me British Council, ChëB dhe eksprteve të Muzeve Kombëtarë të Liverpulit po implementohet projekti i edukimit përmes muzeut në Muzeun Historik Kombëtar. Proces i cili do të vazhdojë më pas edhe në muzetë e tjerë kombëtarë.

Vazhdojnë aktivitetet në mbështetje të nismës së Ministrisë së Kulturës "Miqtë e Monumenteve" e cila konsiston në edukimin e brezit të ri me anë të njohjes, ruajtjes, mbrojtjes, mirëmbajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore shqiptare, përfshirja e shkollave në procesin e mbrojtjes dhe promovimit të monumenteve.

Në këtë kuadër të gjitha DRKK në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore zhvillojnë veprimtari të ndryshme kulturore-artistike, orë mësimore për njohjen me historinë e monumenteve të kulturës si dhe pastrimi dhe mirëmbajtja e këtyre monumenteve nga nxënësit e shkollave që janë pranë këtyre monumenteve, duke realizuar një lloj patronazhi që çdo shkollë do të ketë për një monument. Nisma ka si qëllim :

- 1) Monumentet mbrohen, kanë përkujdesjen, rijetëzohen dhe promovohen nëpërmjet energjisë krijuese të brezit të ri.
- 2) Fëmijët dhe të rinjtë edukohen nëpërmjet potencialit që ofron trashëgimia kulturore.

➤ **Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale**

Në kuadër të krijimit të Fondit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Kulturës nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore vazhdon procesin e katalogimit të objekteve të trashëgimisë kulturore në fushat Arkeologjisë, Artit pamor, Etnografisë, Arkitekturës, etj. për periudhën Janar – shtator 2014 janë regjistruar:

Kartela të reja në Katalogun "ONUFRI", ku janë kataloguar objekte që i përkasin kryesisht institucioneve shtetërore si Muzeu Historik Pogradec, Muzeut Arkeologjik Butrint, Muzeu Arkeologjik Tiranë, Muzeu Arkeologjik Durrës, Muzeu Etnografik Berat. Kartela të reja në Katalogun "MARO KONDI", janë regjistruar kartela të reja me të gjithë të dhënat përkatëse të

personave privatë si dhe janë bërë të gjitha transaksionet për objektet që kanë dalë jashtë vendit. Kartela të reja në Katalogun “**SOTIRI**”, janë regjistruar të gjithë objektet me të dhënat përkatëse dhe ka përfunduar si proces. Projekti për pasurinë trashëgimi: “Foto ekspozitë, Fototeka Sotiri, Korçë” u finalizua me ekspozitën në Korçë në muajin prill 2014. **QKIPK** mban kontakte të bvazhdueshme me të gjithë muzetë e rretheve për inventarizimin dhe katalogimin e objekteve që nuk janë regjistruar në QKIPK, si dhe paisja me foto cilësore të objekteve që janë të regjistruara. Gjithashtu janë bërë Regjistrim të dhënash (pasaporta) dhe shtesave të viteve të fundit në Muzeu Historik Pogradec, Muzeut Arkeologjik Butrint, Muzeu Arkeologjik Tiranë, Muzeu Arkeologjik Durrës, Muzeu Etnografik Berat.

Gjithashtu theksojmë që në shpenzimet kapitale në buxhetin 9 mujor të planifikuar të vitit 2014 krahasuar me buxhetin 2014 të planifikuar, vëmë re një rritje në shpenzimet kapitale, në kuadër të ardhjes së Papa Françeskut në Shqipëri.

3. Programi: “ ARTI DHE KULTURA”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 9- mujori 2014		Realizimi 9- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	374,571	60.8%	365,103	69.2%	97.5%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	124,209	20.2%	105,540	20%	85%
12	01110	231	Kapitale	117,207	19%	56,586	10.7%	48.3%
			TOTALI	615,987	100	527,230	100	85.6%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 86%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 61% të totalit dhe janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet korrente zënë rreth 20% të totalit dhe janë realizuar në masën 85%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 19% dhe janë realizuar në masën 48%
Mosrealizimi i fondeve në masën 14.4% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

në (000) lekë

Programi	Arti dhe Kultura					08230
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit					
	Emri Produktit	PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 9-mujori 2014	Buxhet/Fakt 9-mujori 2014	
A-00325	Veprimtari të realizuara në institucionet e art kultures		628,966	471,725	440,276	
B-00325	Veprimtari të realizuara me fondet e programit art kultures		189,291	134,870	77,562	
C-00325	Perfaqesimi në programe dhe evenimente ndërkombetare		15,563	9,392	9,392	
Totali			833,820	615,987	527,230	

Për realizimin e shpenzimeve buxhetore si dhe argumentimeve përkatëse, për periudhën Janar – Shtator 2014, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Artin dhe Kulturën, në zbatim të politikave qeverisëse dhe Programit Art-Kulturë 2013-2017 në MK, ka vijuar punën për procedimin e secilës praktikë shkresore dhe realizimin e çdo objekti, të parashikuara për këtë periudhë kohore.

Në vijim, kjo Drejtori, ka përforcuar bashkëpunimin me institucionet qendrore të artit dhe kulturës në vend, me qëllim përmirësimin e performancës administrative në art dhe kulturë, duke pasuruar me cilësi artistike, jehonën e krijimtarisë artistike në vend si dhe promovimin e artistëve elitar në skenat botërore. Gjithashtu ka vijuar puna me strukturat e reja të krijuara në aparat dhe pranë institucioneve të vartësisë, në Art dhe Kulturë, si dhe bashkëpunimit me grupet e interesit, për rritjen e audiencave duke zhvilluar programe dhe veprimtari me fokus Edukimin përmes Kulturës me qëllim gjithpërfshirjen e aktorëve në rang Mbarëkombëtar.

Disa prej aktiviteteve të realizuara dhe ato që janë proces:

- Drejt përfundimit me sukses, Reforma strukturore në art, pranë të gjitha institucioneve Kombëtare të artit.
- Pritet për Miratim nga MK, projekti pilot “Atelieja e Edukimit pranë GKA”.
- Mbështetje artistëve dhe produkteve kulturore shqiptare në aktivitete ndërkombëtare.

- Realizimi me sukses i Reformës pranë Institucioneve qendrore Art-Kulturë, e cila bën të mundur nxitjen e krijimtarisë, krijon një sistem të qendrueshëm e transparent punësimi, garanton cilësinë artistike, duke respektuar dinjitetin e artistit dhe duke synuar përfshirjen e të rinjve në këto institucione.
- Në proces pune, Strategjia me fokus Edukimin përmes Kulturës, e cila do të shoqërohet dhe me planin e veprimit/punës. Një ndër elementët përbërës, kryesor të kësaj strategjie është dhe bashkëpunimi me MAS, për rishikimin e teksteve të artit.
- Në proces pune, praktikat shkrese për veprimtaritë artistiko-kulturore që do të realizohen në kuadër të 70 vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë.

Referuar produkteve A, B, C sipas Politikës së Programit 2015-2017

❖ **(Produkti A) - Veprimtari të realizuara në institucionet e Artit dhe Kulturës:**

Ambiente të rikonstruktura në institucionet publike të artit & Rritja e aksesit të publikut pranë institucioneve publike të artit dhe kulturës.

1. Drejt përfundimit procesi i punës për përmirësimin e infrastrukturës si dhe rritjen e standarteve për një shërbim më të mirë ndaj publikut, dhe kushteve të veprimtarisë krijuese artistike – edukuese përmes kulturës, pranë institucioneve qendrore të Artit dhe Kulturës në vend. Shembull, pranë GKA, QRVA, TK, TKOBAP, TKEKS, QKKF ETJ.

2. Atelieja e Edukimit përmes Kulturës

Në proces miratimi pranë MK, Projekti “Atelieja e Edukimit Artistik”, projekt i cili do të vihet në jetë falë bashkëfinancimit dhe bashkëpunimit me Fondacionin për Artet Pamore Shqiptare (FAVA). Projekti i Ateliesë së Edukimit Përmes Kulturës ka në fokus të tij, krijimin e një mjedisi për fëmijët nga mosha 5 - 8 vjeç me të gjitha kushtet e nevojshme konform rregullave të punës edukuese dhe formuese përmes artit me fëmijët e kësaj moshe. Ky projekt është parashikuar të startojë në muajin Dhjetor 2014, (bazuar në planin e punën vënë në dispozicion nga GKA.)

3. Digitalizimi i Bibliotekës Kombëtare

Drejt përfundimit procesi i punës për digjitalizimin e Biblotekës Kombëtare.

❖ **(Produkti B) - Veprimtari të realizuara me fondet e programit Art-Kulturë:**

- *“Thirrjen për projekt-propozime, në Art-Kulturë dhe Trashëgimi Kulturore”, si dhe “Udhëzuesin” mbi procedurat që duhet të ndiqen, në kuadër të mbështetjes dhe administrim i fondit publik për projektet artistike dhe kulturore, për Fazën e I-rë dhe të II-të, 9 mujorin e vitit 2014.*

Drejtorja e Krijimtarisë dhe Edukimit përmes Kulturës dhe Drejtorja e Krijimtarisë së Fjalës dhe Përkthimit, ka arritur të përmbylli me sukses dosjet e projektetke artistike, rast pas rasti sipas situatës së më poshteme:

- **Për fazën e parë** është proceduar me 60% të gjitha projektet e mbështetura nga MK, **nr. 43.**
- Totalisht janë likujduar **11 prej tyre**, pasi kanë paraqitur gjithë dokumentacionin justifikues të projektit pranë zyrës së financës.
- Mbeten në proces likujdimi, **32 prej tyre**, pasi nuk kanë paraqitur dokumentacionin justifikues ose janë në proces realizimi ende.
- **Për fazën e dytë** është proceduar me 60% për të gjitha projektet e mbështetura nga MK, **nr. 33.**
- Totalisht janë likujduar **5 prej tyre**, pasi kanë paraqitur gjithë dokumentacionin justifikues të projektit pranë zyrës së financës.
- Mbeten në proces likujdimi, **28 prej tyre**, pasi nuk kanë paraqitur dokumentacionin justifikues ose janë në proces realizimi ende.

Projekte të tjera të realizuara nga programi Art-Kulturë, për 9 mujorin e vitit 2014:

Në kuadër të vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri më datë 21 shtator 2014, Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet qendrore të Artit dhe Kulturës oragnizuan ndër të tjera, aktivitetet si më poshtë:

1. “*Waiting for the Pope*”
koncert dhe lexime/recitime të materialeve poetike nga autorë me profil religjioz TKOB dhe TK. (Durrës dhe Tiranë)

2. VOX BAROQUE
(Jusuf Beshiri & Abigeila Voshtina) (Durrës-Tiranë-Lezhë)

3. Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Mbrëmje poetike me poezi të De Radës dhe me muzikë arbëreshe.

Program filmash të përzgjedhur nga Doku Fest
Shfaqja e Produksioneve të tre filmave religjioz:

Filmi - Ricardo Bär

Produksioni- Argentina, 2013, Colour, 92 min
Regjia: Nele Eohlatz, Gerardo Naumann

Filmi - Stop the Pounding Heart

Produksioni- USA/Belgium/Itali, 2013, Colour, 100 min
Regjia- Roberto Minervini

Filmi- Journey to the Mount of Tomor / Voyage au mont Tomor

Produksioni- France, 2013, Colour, 52 min

4. Galeria Kombëtare e Arteve

Ekspozitë e piktorit Lin DELIJA "Historia e tij është takimi i Artit me Kishën"

5. Arkivi Qëndror i Filmit Shqiptar dhe Muzeu Historik Kombëtar

- a) RINGJALLJA - Dokumentar me material arkivore mbi besimin fetar, ndalimin nga regjimi komunist dhe ringjallja e tij me ardhjen e demokracisë.
- b) Nënë Tereza, dokumentar mbi jetën dhe aktivitetin bamirës të Nene Terezës, 2003, regjia Kujtim Gjonaj, pranë AQSHF, me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të Tiranës, me fokus Edukimin përmes Kulturës.
- c) ALELUJA, Dokumentar retrospektive mbi vizitën e Papës Gjon Pali II dhe Nene Terezës në Shqipëri në vitin 1992.

6. Biblioteka Kombëtare

Ekspozita **“Katolicizëm dhe kulturë”** e organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë me rastin e vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri, synon të hedhë dritë mbi një nga faktorët më të rëndësishëm të ngjizjes europianiste të kulturës sonë kombëtare: kontributi i personaliteteve dhe i formantes kulturore katolike brendashkruar asaj kombëtare.

7. Ministria e Kulturës

1. Fondi Përkthimit Letrar

“Fondi i Përkthimit Letrar”, vjen si një nismë parësore e Ministrisë së Kulturës në dobi të vlerësimit dhe promovimit të kontributeve më përfaqësuese në lëmin e përkthimit nga gjuha e huaj në shqip. Projekti do të realizohet në shumën prej 2. 392. 500 lekësh nga zëri 604 nga

programin art - kulturë”, nga të cilat me 2340.000 lekë do të paguhen përkthyesit për veprat letrare të shqipëruara nga gjuha e huaj dhe në shumën 52.500 lekë do të paguhen ekspertët e jashtëm. (në proces likuidimi).

2. Logo për 200 vjetorin e lindjes së poetit arbëresh Jeronim de Rada (në proces)

Ministria e Kulturës ka shpallur vitin 2014 “Viti Jeronim De Rada” dhe ka ngritur një Komision Shtetëror me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr.84 datë 17.04.2014 “Për veprimtaritë artistike dhe kulturore që do të realizohen në kuadër të festimeve të 200 vjetorit të lindjes së poetit arbëresh Jeronim De Rada”. Në këtë kuadër Ministria e Kulturës ka vendosur që të ketë një logo zyrtare kushtuar 200- vjetorit të lindjes së poetit . Projekti do të trajtohet nga Galeria Kombëtare e Arteve, nëpërmjet shpalljes së një konkursi me karakter kombëtar. Kostoja finaciare e logos, pas studimit të tregut nga Galeria Kombëtare (shkresë e GKA, nr 2670/1, datë 17.06.2014) do të jetë në shumën 180 000 L (në proces pune).

3. Harta e Kafeneve Letrare në Tiranë e në rrethe.

Projekti “ *Harta e kafeve letrare në Tiranë dhe në Rrethe*” i përgjigjet një prirjeje që është shfaqur në disa lokale të njohura të kryeqytetit për të kryer aktivitete kryesisht me natyrë letrare, duke ftuar poetë, shkrimtarë dhe botues. Projekti synon nxitjen e të rinjve nga një kalim kohe pasiv, drejt një kohe të lirë aktive e sidomos të angazhuar me kulturën e librit. Bar kafetë të cilat plotësojnë kriteret e shpallura në ëeb-in e Ministrisë së Kulturës do të përfitojnë mediatizimin e cilësive artistike që ata plotësojnë dhe nxisin, do të fitojnë një vend në faqen zyrtare online të Ministrisë së Kulturës në kuadër të kësaj fushate nxitëse të leximit dhe klimës artistike, gjithashtu në derën hyrëse kryesore të bar-kafesë së përzgjedhur do të vendoset një logo që simbolikisht do të përfaqësojë dëshirën për lexim, për libër, kulturë.

4. 200-vjetori i lindjes së poetit dhe rilindësit të madh Jeronim De Rada

Ministria e Kulturës, me rastin e 200-vjetorit të lindjes së poetit dhe rilindësit të madh Jeronim De Rada, pati nderin ta shpallë vitin 2014 “Viti De Rada”. Në këtë kalendar janë përfshirë të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar dhe do të zhvillohen në Shqipëri me këtë rast (përfunduar-shpallur).

5. Panairi Ndërkombëtar i Librit Lajpzigut

Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës Shqipëria u prezantua në një nga ngjarjet më të mëdha të librit në Europë me shkrimtarë dhe botues të cilët përfaqësuan botimet shqiptare në arenën Editoriale Botërore.

6. Memorandum Mirëkuptimi mes Ministrisë së Kulturës dhe Këshillit Britanik në Shqipëri.

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit kulturor mes Ministrisë së Kulturës dhe Këshillit Britanik në Shqipëri, marrëveshje e cila ka në fokus të saj, asistencë profesionale nga ekspertë të jashtëm, me qëllim përmirësimin e performancës në institucionet kulturore në Shqipëri (teatro,

muze dhe galeri), përmes rritjes së numrit të vizitorëve/ spektatorëve, (audiencave), në terren dhe bashkëveprim me partnere lokale dhe ndërkombëtare.

❖ **(Produkti C) - Përfaqësimi në programe dhe evidenimente ndërkombëtare:**

Promovimi i imazhit dhe artit shqiptar në arenën ndërkombëtare si dhe sjellja e eksperiencave më të mira të artistëve shqiptarë që jetojnë jashtë në skenat e vendit si psh:

Përfaqësimi i Shqipërisë në Bienalen e Arkitekturës, Venecia, Itali, e cila u çel më datë 7 qershor 2014, e që do të vazhdojë deri më 23 nëntor 2014. Përfaqësimi u realizua me sukses nga 2 kuratorët e pavionit shqiptar”, Znj. Jonida Turani dhe Z. Stefano R. Pansera. Pavioni i Shqipërisë në këtë Bienale, titullohet “Monumente të Mundshëm Ardhmërisht të Perealizuar”, dhe u prezantuan punët e dy artistëve shqiptarë “Penthouse” (Shtesat), një seri pikturash nga Edi Hila dhe “The Column” (Kolona), video/instalacioni nga Adrian Paci. Prezantimi me sukses i Shqipërisë në këtë eveniment të rëndësishëm artistiko-kulturor, pati dhe vazhdon të ketë jehonë gjithëpërfshirëse në fushën e artit vizual botëror, përmes mas-medias, shtypit të shkruar, grupeve artistike elitare botërore, rrjeteve sociale.

Në kuadër të kalendarit të përbashkët Shqipëri – Kosovë, Shqipëri u prezantua me 30 (tridhjetë) skulpturave të Kompleksit skulpturorë “Satira në skulpturë”, të autorit Uran Hajdari, pjesë e Fondit të GKA, në ekspozitën ndërkombëtare “Çmimi Muslim Mulliqi 2014 Edicioni i X-të”, Prishtinë, Kosovë.

1.Pjesëmarrja e QKK, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit, Karlovy Vary 2014, Çeki, me filmin BOTA. Ky film, me regji dhe skenar të Iris Elezi dhe Thomas Logoreci, pati premierën dhe suksesin botëror në festivalin prestigjioz të Karlovy Vary-t, që u zhvillua në Çeki, përgjatë datave 4 - 12 Korrik 2014. Filmi, BOTA, produksion i Era Film, është filmi i bashkëfinancuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Ministria e Kulturës Italiane, mbështetur dhe nga Euroimages. Ministria e Kulturës në mbështetje të prezantimit të filmit shqiptar, në arenën ndërkombëtare, miratoi Urdhrin, Nr. 152/1 Prot, dt. 30.06.2014, “Për financim të përfaqësimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit “Karlovy Vary 2014”, në të cilin mbuloheshin zërat për 2 aktoret protagoniste në këtë film, si dhe për Znj. Milena Selimi, Këshilltare për Mediat pranë MK. Gjithashtu theksojmë që në shpenzimet kapitale në buxhetin 9 mujor të planifikuar të vitit 2014 krahasuar me buxhetin 2014 të planifikuar, vëmë re një rritje në shpenzimet kapitale, në kuadër të ardhjes së Papa Françeskut në Shqipëri.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

